



Lajmet e Fundit: Përfundon misioni i Projektit PAMECA V në Policinë e Shtetit/Dekorohen drejtuesit



Lajmet

17/12/2021

Tiranë – Goditet një tjetër rast i veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve

Shpërndante lëndë narkotike kokainë dhe kanabis, në zonën e Astirit, vihet në pranga 56-vjeçari.

Sekuestrohet lëndë e dyshuar narkotike kokainë, e ndarë në doza gati për shitje, një sasi lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa, një peshore, një armë zjarri pistoletë me mulli, një automjet, një thikë, një sasi parash dhe dy aparate celulare.

Në vijim të goditjeve të njëpasnjëshme ndaj veprimtarisë kriminale në fushën e shpërndarjes së lëndëve narkotike, pas një pune hetimore, bazuar në të dhënat e grumbulluara në rrugë operative nga ana e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, se një shtetas posedonte dhe shpërndante lëndë narkotike kokainë dhe cannabis sativa në zonën e Astirit në Unazë të Re, shërbimet e Policisë kanë organizuar punën për kapjen e tij.

Në rrugën “Teodor Keko”, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar dhe më pas kanë arrestuar në flagrancë shtetasin A. B., 56 vjeç, banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit fizik dhe gjatë kontrollit të banesës së këtij shtetasi, iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale doza me lëndë të dyshuar lëndë narkotike kokainë, një sasi lëndë narkotike të dyshuar cannabis sativa, një peshore elektronike, një shumë parash, një armë zjarri pistoletë, fishekë luftarakë, një thikë, dy aparate celulare dhe një automjet.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”.

Share

Share

Share

Share

Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ DVP Vlorë/ Arrestohen 2 shtetas dhe procedohen penalisht 6 shtetas të tjerë, për vepra të ndryshme penale

Tiranë – Vihen në pranga 3 persona të shpallur në kërkim për vepra të ndryshme penale ▶